

V E N D I M
Nr.612, datë 6.11.1995

**PËR FAVORIZIMIN E INVALIDËVE NË SISTEMIN E KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE**

Në mbështetje të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të gjithë invalidët që gëzojnë zyrtarisht statusin si të tillë, në bazë të ligjit të sipërpërmendur, kanë të drejtë të hyjnë në të gjitha llojet e institucionet buxhetore e jobuxhetore, për të gjitha llojet e veprimëtarive kulturore e artistike, rinore e sportive, që zhvillohen në mjedise publike, të hapura ose të mbyllura.

2. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, në nivel kombëtar e lokal, janë të detyruara të pranojnë në çdo rast ata invalidë që paraqesin dëshminë e invaliditetit, për të gjitha veprimëtaritë, kundrejt pagesës prej 50 për qind të çmimit të biletës, të vendosur për atë shfaqje ose veprimëtar.

Invalidi, në momentin e prerjes së biletës, duhet të paraqesë dokumentin identifikues që e njeh zyrtarisht si të tillë, siç parashikohet në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

3. Për pjesëmarrjen e invalidëve në veprimëtaritë të tilla, institucionet janë të detyruara të rezervojnë për ta vende të përshtatshme.

4. Personeli i shërbimit të institucionit ku zhvillohet veprimëtaria, duhet ta ndihmojë invalidin pa asnjë lloj shpërblimi, për t'i siguruar atij një qëndrim sa më normal në institucion, gjatë kohës së zgjatjes së veprimëtarisë.

5. Invalidët të favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit profesional që zhvillojnë institucionet e sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve.

6. Mjediset që institucionet shtetërore të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve vënë në dispozicion të Shoqatës së Invalidëve për të zhvilluar veprimëtarinë e tyre, vihen në përdorim pa shpërblim.

7. Efekti financiar që rrjedh nga shitja e biletave me 50 për qind të çmimit, të përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi